



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.1236/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar kolegji, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike të paditësve 1. AS Film shpk me seli në Prishtinë dhe 2. A.S. nga Prishtina, të cilët i përfaqëson Shoqëria e avokatëve Havolli&Partners, me avokaten S.B. nga Prishtina, kundër të paditurës Qendra Kinematografike e Kosovës (QKK) me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson A.Z., për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësueses së autorizuar të palës paditëse, e parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KE.nr.1377/22 datës 06.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 18.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësve AS Film shpk me seli në Prishtinë dhe A.S. nga Prishtina, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, K.E.nr.1377/22 i datës 06.04.2023, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar KE.nr.1377/22 të datës 06.04.2023, Dhoma e shkallës së parë, ka vendosur si në vijim: I Refuzohet në tërësi si i pabazuar kërkesëpadia e paditësve 1. AS Film shpk me seli në Prishtinë dhe 2. A.S. nga Prishtina, me të cilën kanë kërkuar që të konstatohet se kontrata nr.ref.nr.QKK/03-170818 e datës 17.08.2018 është shkëputur në mënyrë të një anshme dhe pa bazë ligjore si dhe të Detyrohet e paditura Qendra Kinematografike e Kosovës me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit të shkaktuar t,ia paguaj paditësit As Film shpk shumën prej 140.000.00€ si dhe në emër të dëmit jo material paditësit A.S., t,ia kompensoi shumën prej 10,000.00€, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 4,265.60€.

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë përfaqësuesja e autorizuar e paditësve, për shkak të shkeljeve procedurale nga neni 182 par.2 pika n LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e apelit ta aprovtoj si të bazuar ankesën e paditësve, ashtu që ta ndryshoj aktgjykimin K.E.nr.1377/22 i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, dhe të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësve.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit 1. AS Film shpk me seli në Prishtinë dhe 2. A.S. nga Prishtina, përmes përfaqësuesve të autorizuar me datën 07.09.2019 kanë paraqitur padi pranë gjykatës së shkallës së parë, kundër të paditurës Qendra Kinematografike e Kosovës (QKK) me seli në Prishtinë, për shkak të shkëputjes së njëanshme të Kontratës ref.nr.QKK/03-170818 dhe kompensim dëmit. Ndër të tjera në padi dhe në seancat gjyqësore përfaqësuesja e autorizuar e paditësve ka pretenduar se paditësi i parë dhe e paditura kanë lidhur kontratë me nr.Ref.QKK/03-170818 me objekt të kontratës subvencionimi i projekti filmik të metrazhit të gjatë me titull “Rapsodia e Muzgut” projekt i AS Film, këtu paditëses së parë me skenar të Z.K. dhe regji të A.S., këtu paditësi i dytë. Sipas nenit 5 të kontratës e paditura ka marrë obligim që subvencionimin ta realizoj në tri faza. Pas nënshkrimit të kontratës As Film ka filluar realizimin e projektit. E paditura pa paralajmërim të palëve njëanshëm dhe pa asnjë bazë ligjore me datë 05.04.2019 ka nxjerr vendimin nr.06/2019 me të cilin anulon vendimin nr.27/2018 dt.03.08.2018 dhe shkëputjen e kontratës nr.QKK/03-170818 dt.17.08.2018, duke arsyetuar ne Ligjin për parandalimin e Konfliktit të interesit. Në seancën gjyqësore e autorizuar e paditësve ka qëndruar pranë kërkesëpadingë duke shtuar se rasti “A.S.” nuk përbën konflikt të interesit, sepse subvencionimi nuk ka qenë për personin A.S., por në cilësinë e regjisorit në projektin e AS Film. Në kohën kur është nënshkruar kontrata, paditësi i dytë Sopi, nuk ka ushtruar asnjë pozitë apo funksion në këtë subjekt, pasi është shkarkuar me vendimin nr.898/2018 dt.26.03.2018 nga Këshilli Drejtues i TKK dhe është kthyer pas datës 10.09.2018 sipas vendimit A.nr.453/2018 të KPM. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadingë e paditësve ta aprovoj në tërsi si të bazuar.

I padituri në përgjigje në padi dhe gjatë seancave gjyqësore ka kundërshtuar në tërsi kërkesëpadingë e paditësve, duke theksuar se paditësit të dytë A.S. i mungon legjitimiteti real aktiv në këtë çështje, meqë kontrata QKK/03-170818 dt.17.08.2010 ka qenë e lidhur mes paditurës QKK dhe paditësit të parë AS Film dhe pasi që pronësia është bartur nga paditësi i dytë A.S. tek bashkëshortja e tij, nënkupton se nuk ka patur ndonjë raport kontraktual në mes paditurës dhe paditësit të dytë. AKK me datë 08.02.2019 ka kthyer përgjigje duke njoftuar të paditurën, se rastet e natyrës së njëjtë janë trajtuar edhe më herët prandaj kjo temë është çështje e gjykuar referuar dispozitave të Ligjit për Shërbyes Civil neni 5 par.8. QKK ka nxjerr vendimin nr.06/2019 me të cilin është anuluar vendimi KD.nr.27/2018 dhe është shkëputur kontrata e lidhur. Nga ARBK kanë pranuar konstatimin se biznesi AS Film ka qenë në pronësi të A.S., i cili më pastaj me kontratë ka bartur pronësinë të vajza e tij, e nga kjo vërtetohet se paditësi i dytë megjithatë ka qenë pronar i parë dhe nëse nuk do të ishte shkëputur kontrata i njëjti do të përfitonte edhe në cilësinë e regjisorit dhe gjithashtu do të ushtronte pozitën e drejtorit të Teatrit Kombëtar.

Dhoma e shkallës së parë në rigjykim, duke vepruar sipas vërejtjeve dhe rekomandimeve të Aktgjykimin Ae.nr.111/20 datës 16.09.2021 i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pas administrimit të provave në seancën gjyqësore datës 23.03.2023 e mbajtur në prani të përfaqësuesve të autorizuar të

palëve ndërgjyqëse, ka marr aktgjykimin me të cilin ka Refuzuar në tërsi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit ankimor.

Në arsyetim të aktgjykimit, dhoma e shkallës së parë, pas shtjellimit të gjitha provave të administruara në shqyrtimin kryesor, gjendjen faktike lidhur me shkëputjen e kontratës nga ana e të paditurit sipas vendimit KD.nr.06/2019 datës 05.04.2019, konsideron se nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore, duke u referuar në nenin 89 par.1 të Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Më tej theksohet se kontrata kontestuese nr.QKK/03-170818 datës 17.08.2018 është përfshirë në konflikt interesi dhe si e tillë nuk krijon efekt juridik, pra nuk krijon fare të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese sepse është lidhur në kundërshtim me normat imperative respektivisht me nenin 1.8 të Ligjit 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës. Prandaj gjykata referuar kësaj dispozite ligjore vlerëson se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar sepse kontrata e lidhur mes palëve ndërgjyqëse përbën kontratë nule që nuk krijon të drejta dhe detyrime për palët.

Dhomat e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të dhomës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2 pika (n) e LPK, për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, apo për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, të cilat shkelje pretendohen në dy ankesat e palëve ndërgjyqëse.

Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, vlerësoi se dhoma e shkallës së parë, ka vepruar drejt kur me aktgjykimin e atakuar, ka marrë për bazë rekomandimet e gjykatës së Apelit (Aktgjykimi Ae.nr.111/20, lidhur me gjendjen faktike, në drejtim të vërtetimit të fakteve se a kemi të bëjmë me konflikt interesi.

Kolegji vlerësoi, se dhoma e shkallës së parë, në rigjykim, pas vërtetimit të gjendjes faktike nga provat e administruara, respektivisht përgjigjet me nr.protok.03-02/176/19 datës 13.02.2019 dhe nr.protok.03-02/3136/16 datës 16.09.2016 të lëshuara nga Agjencia kundër Korrupsionit, ka zbatuar drejt ligjin duke e nxjerr konstatimin se kontrata e lidhur me datën 10.08.2018 ndërmjet Qendrës Kinematografike të Kosovës, dhe AS Film, me regjisor A.S., është kontratë nule që nuk krijon të drejta dhe detyrime për palët, në vështirësi të nenit 89 të LMD-së, pasi që në shkresat e lëndës vërtetohet se paditësi i dytë A.S. ka lidhur Kontratën mbi Autorin dt. 10.08.2018 me përfaqësuesin e paditësit të parë, (neni 5) ku autori në këtë rast paditësi i dytë A.S. do të realizoj honorar autorial prej 7% nga buxheti total i realizimit të projekti të filmit.

Fakti se paditësi i dytë në kohën e lidhjes së kontratës dt.10.08.2018 për realizimin e projekti të filmit të metrazhit të gjatë “Rapsodia e Muzgut” e subvencionuar nga QKK, ka qenë nëpunës i Ministrisë së Kulturës, i cili pas shkarkimit nga pozita e drejtorit të përgjithshëm të Teatrit Kombëtar të Kosovës, ka ndjekur procedurat ankimore në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK), që me vendimin A.nr.453/2018 ky organ kompetent ka aprovuar ankesën e paditësit të dytë, dhe paditësi i dytë në këtë periudhë ka bërë bartjen e pronësisë te personi i tretë, Kolegji vlerësoi se me të drejt dhoma e shkallës së parë është referuar në dispozitën e nenit 89 par.1 të Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, që përcakton: *Kontrata që është në kundërshtim*

me rendin publik, dispozitat urdhëruese, ose moralin e shoqërisë është nule, në qoftë se qëllimi i rregullës së cenuar nuk udhëzon në ndonjë sanksion tjetër apo në qoftë se ligji në rastin e caktuar nuk parashikon diç tjetër. Gjithashtu është zbatuar drejt neni 5 paragrafi 1 pika 1.8 të Ligjit 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (SHCK), me të cilën përcaktohet: Nëpunësit civilë duhet të mos lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin kryerjen e detyrave private ose publike, që bien ndesh me pozitën e tyre dhe që mund të krijojnë konflikt interesi. Nëpunësit civilë veprojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe ligjit në fuqi për shmangien e konfliktit të interesit.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së dytë, i vlerëson si të pabazuara pretendimet ankimore se paditësi i dytë nuk është shërbyes civil dhe nuk aplikohet ndaj tij neni 4 i Ligjit për Shërbyesit Civil. Nga provat e lëndës Kolegji vërtetoi se në kohën e lidhjes së kontratës për realizmin e projektit të filmit “Rapsodi i Muzgut”, dhe pas shkarkimit të paditësit të dytë A.S. nga pozita e drejtorit të Teatrit Kombëtar të Kosovës, konstatohet se paditësi i dytë, ka qenë i përfshirë në realizmin e projektit të subvencionuar nga QKK, të filmit “Rapsodi i Muzgut”, veprim ky që në rast të përfitimit të fondeve nga institucioni për subvencionimin e projektit, paditësi i dytë do të krijonte konflikt interesi, i cili bie ndesh me ligjin.

Kolegji i vlerësoi edhe pretendimet ankimore, se paditësi i dytë si regjisor në kontratën e nënshkruar mes QKK dhe AS Film, obligohej që punën e tij ta bëj pa kurrfarë kompensimi material nga granditësi i QKK, mirëpo Kolegji vlerësoi se këto pretendime janë në kundërshtim me shkresat e lëndës, sepse paditësi i dytë A.S. ka nënshkruar Kontratën mbi Autorin e datës 10.08.2018, me Shtëpinë Prodhuese AS Film, ku në nenin 5 të kontratës është përcaktuar se pagesa për honorar, autorit në këtë rast A.S. do ti paguhet 7% nga buxheti që sigurohet për realizmin e projektit të filmit të subvencionuar “Rapsodia e Muzgut”.

Kolegji vlerësoi se nga provat e administruara nga dhoma e shkallës së parë, pretendimet e paditësve lidhur me gjendjen faktike, dhe zbatimin e gabuar të drejtës materiale, gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse pretendimet janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Kolegji vlerësoi se aktgjykimi ankimor gjen mbështetje ligjore sepse kontrata kontestuese nr.QKK/03-170818 datës 17.08.2018 ku paditësi i dytë A.S., në pozitën e autorit, është përfshirë në konflikt interesi, me rastin e subvencionimit të filmit të gjatë “Rapsodët e Muzgut”, prandaj në bazë të edhe opinionit ligjor të të zyrës ligjore nga QKK dhe përgjigjes nr.proto. 03-02/176/19 datës 13.02.2019 dhe nr.protok. 03-02/3136 datës 16.09.2016 të AKK, rezulton përfitimi i subvencionit nga QKK për projektin Rapsodia e Muzgut, përbën konflikt interesi.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i dhomës të shkallës së parë, nuk ka të meta për shkak të se cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, nuk është përfshirë më ndonjë shkelje e cila do të ishte me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmbanë arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Dhomat e shkallës së dytë.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.1236/2023 datë 18.01.2024

Kryetari i Kolegjit – Gjyqtari
Krenar Berisha